

Klubi studentor

2-A është mbulesa (hixhabi) pjesë e Sheriatit (ligjit) Islam dhe një nga detyrimet e tij? Nëse kjo motër me ndershmeri do të ishte thelluar në këtë çështje duke dëshiruar të vërtetën, përgjigja e saj do të ishte: Po. All-llahu i madhëruar të cilit ti i beson është Ai i Cili ka urdhëruar mbulesën për gratë në librin e Tij, dhe Profeti fisnik (që ti beson në mesazhin e tij ka urdhëruar për mbulesën në sunnetin e tij). Si ta quajmë këtë, të duash Islamin dhe të mos bësh atë të cilën ka urdhëruar All-llahu [subhanehu ve tealja] dhe i dërguari i Tij [sal-lall-llahu alejhi ve selem]?! Si do qoftë ky njeri nuk është prej atyre të cilëve All-llahu [subhanehu ve tealja] thotë për ta: „**Fjala e vetme e besimtarve të vërtetë, kur ata thirren tek All-llahu dhe i Dërguari i Tij për të gjykuar mes tyre është të thonë: 'Dëgjua dhe u bindëm'. Dhe mu këta janë ata që fitojnë lumturinë**” (xhenetin)”. (Nur: 51).

Si përfundim mund të themi se nëse kjo motër është e kënaqur me Islamin si atëhere nuk qenka e kënaqur me urdhëresat e tij?!

Shkaku i dytë: Thotë e dyta: “Unë jam e kënaqur që të vë hixhabin (mbulesën), por nëna ime nuk më lejon ta vë atë dhe nëse nuk i bindem asaj do të hyj në zjarr”. Këtij justifikimi të kësaj motre i përgjigjet krijesa më fisnike e All-llahut i dërguari i Tij me fjalën e tij të urtë: „*Nuk lejohet ti bindesh krijesës duke bërë mëkat ndaj Krijesit*”. Pozita e prindërve në Islam e veçanërisht ajo e nënës është mjaft e lartë madje All-llahu [subhanehu ve tealja] e ka vënë atë pranë urdhëresës më të madhe e që është adhurimi i Tij dhe njëhësi i Tij në mjaft vënde në Kuran siç thotë: „**Adhuroni All-llahun dhe mos i vini Atij shok në adhurim, dhe u bëjuni mirësi prindërve...**” (Nisa: 36).

Bindjes ndaj prindërve asgjë nuk i del përpara përveç nëse ata të urdhërojnë për diçka që është mosbindje ndaj All-llahut [subhanehu ve tealja]. Thotë i Lartësuar: „**Por nëse ata të dy përpiqen me ty që ti të më bësh ortak Mua në adhurim për të cilët nuk ke asnjë dije atëherë mos iu bind atyre**” (Lukman: 16).

Në përfundim themi: Si mund t'i bindesh nënës tënde duke mëkatuar ndaj All-llahut [subhanehu ve tealja] i Cili të ka krijuar ty dhe nënën tënde?!

Shkaku i tretë: Përsa i përket të tretës ajo thotë: „**Mundësitë e mia materiale nuk më mjaftojnë që të zëvendësoj rrobat që kam me të tjera**”. Kjo motra jonë ose është me të vërtetë e sigurtë në atë që thotë ose gënjen për t'i ikur vjedhurazi përgjigjes apo ajo ndoshta dëshiron një hixhab (mbulesë) që të shkojë edhe me modën e i shtrenjtë në kosto. Por le ta fillojmë me të parën: A di ti moj motër se gruas muslimane nuk i lejohet të dalë nga shtëpia në çfarëdo lloj rasti përderisa të mos ketë plotësuar veshja e saj kushtet e parashikuara për hixhabin nga ana e Sheriatit të cilat çdo muslimane duhet detyrimisht t'i dijë. Nëse ti je e gatshme të mësohesh çështje që i përkasin kësaj dynjaje pse nuk tregohesh po aq e preokupuar për të mësuar ato gjëra të cilat do të shpëtojnë ty nga ndëshkimi i All-llahut [subhanehu ve tealja] dhe zemërimi i Tij mbas vdekjes ...?! A nuk thotë All-llahu i Lartësuar: „**Pyesni njerzit e dijes nëse nuk dini**”

Mësoja pra këto gjëra motra ime se vërtetë të duhen. Nëse është e domdoshme që të dalësh atëherë mos dil veçse duke qenë e mbuluar sipas rregullave të fesë që të kënaqesh Zotin tënd e të poshtëros djallin. Dëmet që sjell dalja jote e zbuluar dhe e pispillosur është shumë më e madhe se sa përfitimet që mund të kesh në rast nevojë. Motra ime! Nëse vërtetë do kishe nijetin e pastër dhe do të ishte e vendosur, drejt teje do të ishin zgjatur me mijëra duar bamirësie dhe All-llahu [subhanehu ve tealja] do ta kishte lehtësuar ty punën

a nuk është Ai që thotë: „**Dhe kushdo që ka frikë All-llahun, Ai atij do ti jap rrugëdalje dhe do ta furnizoj atë nga se për**” (Talak: 2-3)

Ndërsa motrës tjetër do ti themi: Fisnikëria dhe pozita e lartë tek All-llahu [subhanehu ve tealja] nuk arrihet nëpërmjet rrobave të bukura dhe të shtrenjta dhe as duke ndjekur modën e kohës por duke iu bindur All-llahut [subhanehu ve tealja] dhe të dërguarit të Tij [sal-lall-llahu alejhi ve selem] dhe duke zbatuar gjithçka që urdhëron Sheriati në lidhje me hixhabin Islam. Dëgjo se ç'thotë All-llahu i Madhëruar në Librin e Tij: „**Më fisniku ndër ju është ai që më tepër i frikësohet All-llahut**”. (Huxhurat: 13).

Në rrugën drejt kënaqësisë së All-llahut [subhanehu ve tealja] dhe Xhenetit të Tij shuhet çdo dëshirë dhe tekë.

Shkaku i katërt: Erdhi radha e së katërtës e cila tha: „**Në vendin tim temperaturat janë të larta dhe ajri është mjaft i nxehtë dhe unë se duroj dot dhe si i bëhet hallit nëse unë vesh edhe hixhabin ?**”. Një njeriu të tillë si puna kësaj All-llahu [subhanehu ve tealja] i thotë: „**Thuaju: 'Zjarri i xhehenemit është akoma më i fortë në nxehtësi (se vapa e diellit). Veç sikur mund ta kuptonit!**” (Teube: 81).

Si pra mund ta marrësh në konsiderat nxehtësinë e kësaj bote para nxehtësisë së Xhehenemit! Dije motër se ti me këto mendime ke rënë pre në një nga rrjetat e djallit për të të nxjerr ty nga nxehtësia e kësaj bote dhe për të të hedhur në zjarrin e Xhehenemit, shpëto pra veten tënde nga nga kjo rrjetë e tij dhe konsidero nxehtësinë e diellit në një mirësi dhe jo një vuajtje, cila do të të kujtoj ndëshkimin e All-llahut [subhanehu ve tealja], sakrifikoe pra rehatinë e kësaj bote për të shpëtuar veten nga zjarri i All-llahut, për banorët e të cilit All-llahu [subhanehu ve tealja] thotë: „**Asgjë të freskët nuk do të shijojnë atje as dhe pije. Përveç ujë që valon dhe kullimin e plagve të qelbura**”. (Nebe: 24- 25).

Xheneti është i rrethuar me vështirësira e ndërsa zjarri me lehtësira, cila është pra zgjidhja jote...?

Shkaku i pestë: Le të dëgjojmë tani justifikimin e së pestës kur ajo tha: „**Kam frikë se nëse e vë hixhabin mund ta heq atë përsëri, s'janë të pakta ato që kam parë që e kanë bërë një gjë të tillë!**” Kësaj motre i themi: Nëse të gjithë njerzit do të llogjikonin me këto mend e tua do ta kishin lënë fenë fare, do ta kishin lënë namazin sepse ka prej atyre që kanë frikë se mos e lënë po kështu do ta kishin lënë edhe agjërimin sepse ka edhe njerëz të tillë që kanë frikë se mos e lënë ... e kështu me rradhë. A nuk e shikon se si përsëri shejtani të hodhi në kthetrat e tij duke të larguar nga rruga e drejtë?! All-llahu i Madhëruar e do vazhdueshmërinë në bindje ndaj Tij edhe nëse kjo është diçka e vogël apo fakultative, e si atëherë kur ajo është një obligim i detyruar siç është rasti i hixhabet (mbulesës)?! Përgjigja [sal-lall-llahu alejhi ve selem] thotë: „**Puna më e dashur tek All-llahu është ajo që është e vazhdueshme edhe nëse është e vogël**”.

Pse nuk kërkon të dish se cilat ishin shkaqet që çuan ato në një veprim të tillë kaq të shëmtuar në mënyrë që t'i shmangesh dhe mos të biesh në të njëjtë pozita? Pse nuk kërkon të dish se cilat janë ato elemente të cilat do të forcojnë qëndrueshmërinë tënde në fe dhe të bëjnë të mbahesh fortë mbas së vërtetës?

Ja disa prej tyre: Shpeshtimi i lutjeve (duave) që All-llahu [subhanehu ve tealja] të forcojë zemrën në këtë fe ashtu siç bënte edhe i dërguari i All-llahut (përqëndrimi në namaz duke ndier prezencën e All-llahut në të: „**Dhe kërkonte ndihmë me durim dhe me falje e është e vërtetë se kjo është tejet e rëndë dhe e**

vështirë përveç atyre që janë të drojtur nga All-llahu”. (Bekare: 45).

Po kështu zbatimi i të gjitha obligimeve islame e prej tyre edhe hixhabi, thotë i Madhëruari: „**Sikur të kishin zbatuar për çfarë ishin urdhëruar do ishte shumë më mirë për ta dhe do ta kishin forcuar edhe më vetveten e tyre**” (besimin e tyre).” (Nisa: 66).

E pra nëse do të ishte kapur pas këtyre shkaqeve dhe do ta kishe shijuar ëmbëlsinë e imanit (besimit) nuk kishe për t'i lënë urdhëresat e All-llahut [subhanehu ve tealja] pas të cilave ishte kapur.

Shkaku i gjashtë: Ja ku është edhe e gjashta çfarë thotë ajo? Ajo thotë: „**Mua më kanë thënë se nëse mbulohem askush nuk ka për tu martuar me mua, prandaj më duhet ta lë këtë çështje deri sa të marthohem**”. Ai burrë i cili dëshiron të marthohet me ty duke qenë e zbuluar dhe e zhveshur, mëkatore ndaj All-llahut [subhanehu ve tealja] nuk është një burrë i denjë i cili meriton të bëhet bashkëshorti yt. Ai është një bashkëshort që nuk i merr në konsiderat ndalesat e All-llahut [subhanehu ve tealja] e nuk bëhet xheloz as për ty, një njeri të tillë nuk ka se si të ndihmojë që të hysh në Xhenet e të shpëtosh nga zjarri. Një shtëpi e cila që nga fillimi ngrihet mbi mëkatin dhe zemërimin e All-llahut [subhanehu ve tealja] është e drejtë e Tij që ta kthejë atë në një familje të dështuar në këtë botë dhe në tjetrën: „**Por kushdo që i kthen shpinën Mesazhit Tim padyshim për të do të ketë jetë të vështirë dhe Ne do ta ngremë të verbuar në Ditën e Ringjalljes**”. (Taha: 124).

Pa dyshim që martesë është një mirësi e All-llahut [subhanehu ve tealja] të cilën ia jep kujt të dojë, sa prej atyre të mbuluarave janë martuar e sa prej atyre të tjerave të zbuluarave kanë mbetur pa martuar... Nëse thua: „Zbukurimi dhe zbulimi që unë i bëj vetes është një mjet për një qëllim të pastër dhe që në këtë rast është martesë”, dije se qëllimi i pastër nuk e bën hallall një mjet amoral në fenë Islame. Nëse qëllimi është fisnik atëherë patjetër edhe mjeti duhet të jetë i tillë sepse një rregull mjaftë e njohur Islame thotë: „Mjeti gjykohe sipas qëllimit”. E pra All-llahu [subhanehu ve tealja] mos e bekoftë atë martesë që ngrihet mbi mëkatin dhe shturjen.

Shkaku i shtatë: Cila është fjala yte moj e shtatë? Ajo tha: „**Unë nuk mbulohem sepse All-llahu thotë: 'Dhe me të mirat që të dha Zoti yt fol'**”. (Ed Duha: 11).

E si pra ta fsheh unë këtë mirësi që më dha All-llahu [subhanehu ve tealja] me këto fletë të ndritshëm dhe këtë bukuri provokuese? Kjo motra jonë kapet mbas Librit të All-llahut dhe urdhërohet të Tij aty ku i përshtaten dëshirat dhe të kuptuarit e saj! Dhe po kjo është ajo që i lë këto urdhëra kur nuk i pëlqejnë asaj në mos është kështu atëherë pse nuk i bindesh fjalës së All-llahut: „**Dhe të mos i nxjerrin hapur bukurinë e tyre përveç asaj që është e dukshme**” (Nur: 31). Apo fjalën e All-llahut [subhanehu ve tealja]: „...**e le të lëshojnë vallon** (mbulesën) **e tyre mbi gjithë trupin**”. (Ahzab: 59).

E ti moj motër me këto fjalë nuk ke bërë gjë tjetër veçse i ke lejuar vetes atë të cilën ka ndaluar All-llahu [subhanehu ve tealja], të zhvishesh e të zbulohesh. Dhe e gjithë kjo pse? Sepse nuk ke dëshirë ti bindesh këtyre urdhëresave. Mos harro se mirësia më e madhe e All-llahut [subhanehu ve tealja] ndaj nesh është mirësia e besimit dhe e udhëzimit, e përse atëherë nuk e shfaq dhe nuk flet për këtë mirësi të madhe të All-llahut [subhanehu ve tealja] ndaj teje e një prej tyre është edhe hixhabi (mbulesa) që duhet të mbaj gruaja? A ka ndonjë mirësi më të madhe nga All-llahu [subhanehu ve tealja] për bes-

imtarene se sa besimi dhe mbulesa ?!

Shkaku i tetë: Vimë tani tek motra jonë e tetë e cila thotë: „Unë e di që hixhabi është detyrim që duhet të kryhet, por do ta vë atë kur të më udhëzojë All-llahu”. Le ta pyesim këtë motër se cilat janë hapat që ajo hodhi për të arritur deri tek ky udhëzim hyjnor? Ne dimë se All-llahu [subhanehu ve tealja] me urtësinë e Tij ka bërë që çdo gjë të ketë shkaku e saj. Kështu i sëmuri që të shërohet duhet të marrë ilaçin ashtu siç udhëtari duhet t'i hypë automjetit apo kafshës për të arritur atje ku dëshiron e kështu me rradhë mund të japim një pafundësi shembujsh për këtë gjë. A vërtetë kjo motra jonë punoi me mish e me shpirt për ta arritur këtë udhëzim apo... A ju lut ajo All-llahut me sin- qeritet:

„Udhëzohet në rrugën e drejtë”. (Fatiha: 6).

A qëndroi ajo me besimtaret e devotshme? Ato janë ndihma më e mirë që do t'i jepte vetvetes për t'u udhëzuar dhe për të mos u lëkundur më nga rruga. Nëse vërtetë kjo motër do të ishte serioze në kërkimin e udhëzimit atëherë do ta kishte arritur atë.

Shkaku i nëntë: Çfarë thotë motra jonë e nëntë? Ajo thotë: „Akoma nuk ka ardhur koha që unë të mbulohem, kur të rritem dhe ca dhe pasi të kryej edhe Haxhin atëherë do ta vë hixhabin”. Engjëlli i vdekjes moj motër është vizitor i cili qëndron gjithmonë pranë portës tënde ai në çdo moment pret t'i vijë urdhëri i All-llahut [subhanehu ve tealja] për të ta marr shpirtin tënd nga çasti në çast: „Dhe kur vjen ky çast ata as nuk mund ta vonojnë atë dhe as nuk mund ta sjellin më pranë.” (Araf: 34).

Vdekja moj motër nuk njihet të vogël e as të madh, ajo mund të të vij dhe të të gjej në këtë gjendje, mëkatore, e zhveshur dhe e zbuluar në luftë kundra urdhërësave të Zotit [subhanehu ve tealja]. Motra ime! Shpejto t'i përgjigjesh thirrjes së Zotit tënd: „Vraponi drejt faljes nga Zoti juaj dhe drejt Xhennetit gjersia e të cilit është sa gjersia e qiellit dhe tokës.” (Hadid: 21).

Motër e nderuar! Mos e harro All-llahun [subhanehu ve tealja] që Ai të të mos harroj ty duke largur prej teje mëshirën e Tij në të dyja botët, mos e harro vetveten, por jepi asaj atë që i takon në bindjen ndaj All-llahut [subhanehu ve tealja] mos u bëj si hipokritet për të cilët All-llahu [subhanehu ve tealja] thotë: „Ata e harruan All-llahun dhe Ai i harroi ata (i largoj nga mëshira e Tij)”. (Teube: 67).

„Dhe mos u bëni si ata që harruan All-llahun dhe që Ai i bëri të harrojnë vetveten e tyre.” (Hashr:19).

Largohu nga çdo mëkat qofsh edhe në këtë moshë të vogël sepse All-llahu [subhanehu ve tealja] si Ndëshkues i ashpër që është do të të pyet në ditën e Kجامetit për çdo moment të jetës tënde se si e kalove. Çudi sa siguritë e ndien veten! Kush të siguron se do të të zërë e nesërmja?

Shkaku i dhjetë: Dhe së fundi e dhjeta tha: „Kam frikë se nëse vishem me hixhab njerëzit do të thonë se jam prej këtij apo atij grupi e unë nuk i duroj dot këto gjëra”. Në Islam moj motër ka vetëm dy grupe të cilat na i përmend All-llahu [subhanehu ve tealja] në Librin e Tij: Grupi i parë është ai i All-llahut, janë ata të cilët u binden urdhërave të Tij dhe i largohen ndalesave të Tij. Ndërsa grupi i dytë është ai i djallit të mallkuar të cilët nuk i binden Mëshiruesit, por shkaktajnë trubullira në tokë. Ti kur i bindesh All-llahut dhe vë hixhabin e vë veten në rradhën e atyre që i përkasin grupit të All-llahut [subhanehu ve tealja], të shpëtuarit e ndërsa kur pispilloshesh e del e zbuluar

Klubi studentor

duke ekspozuar pjesët provokuese të trupit nuk ke bërë gjë tjetër veçse i ke hypur anijes së djallit bashkë me hipokritet dhe mosbesimtare e sa mikesha të këqija që janë ato. A nuk e shikon se i largohesh All-llahut [subhanehu ve tealja] për të shkuar drejt djallit?! A po e zëvendëson të mirën me të keqe?! Ec drejt Zotit dhe zbato urdhërësat e Tij: „**Ikni pra drejt All-llahut. Vërtetë që unë jam këshillues i qartë për ju nga Ai**”. (Dharijat: 50).

Hixhabi është një formë adhurimi ndaj Zotit dhe nuk i nënshtrohet opinioneve të njerzëve apo dëshirave dhe zgjedhjeve të tyre sepse Ai që e vendosi atë ishte vetë Krijuesi, i Urti. Në rrugën për të arritur kënaqësinë e All-llahut, Xhennetin dhe mëshirën e Tij hodhi mbas shpine çdo fjalë që vjen prej djallit dhe kompanisë së tij prej njerzëve dhe xhinëve dhe shtrëngohu fort mbas fesë dhe mos e harro asnjëherë shembullin e nënave të besimtareve, besimtareve të para të cilat luftuan bashkë me Profetin [sal-lall-llahu alejhi ve selem] për të qenë shembulli më i mirë për ata të cilët do të vinin më pas. Motër e respektuar! Po të flas me gjithë mend! Trupi yt reklamohet përditë në tregun e djallit për të hutuar njerzit; flokë të shëndritshme që derdhen mbi supet e tua, rroba të ngushta të cilat të tregojnë pjesët e trupit tënd, aq të shkurtra sa që zbulohen këmbët dhe kofshët, të zbukuruara, të pispillosura e të parfumosura... E pra dije se që të gjitha këto nuk bëjnë gjë tjetër veçse zemërojnë All-llahun [subhanehu ve tealja] dhe kënaqin djallin... Çdo ditë që kalon dhe ti je në këtë gjendje, çdo ditë e më pranë djallit shkon dhe nga Zoti largohesh çdo ditë një mallkim i ri dhe zemërim nga qielli bie mbi ty derisa të pendohesh, për çdo ditë i afrohesh varrit dhe engjëlli i vdekjes përgatitet për të të marrë shpirtin: „**Gjithsecili do ta shijoj vdekjen dhe vetëm në Ditën e Ringjalljes do t'ju paguhet plotësisht shpërblimi i juaj. Dhe kushdo që do të largohet prej Zjarrit dhe do të shtihet në Xhennet vërtet ai ka fituar . Jeta e kësaj bote është vetëm një kënaqësi mashtruese.**” (Ali Imran: 185).

Hypi trenit të pendimit para se të largohet nga stacioni yt, kushtoi rëndësi këtyre fjalëve sot para se të vijë e nesërmja, mendohu tani para se koha të iki dhe vendosshmëria yte të dobësohet...

Dr.Huejda Ismail

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën.

Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të

ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



E falënderoj All-llahun e madhëruar ashtu siç i takon madhështisë dhe sundimit të Tij. Paqe dhe bekime dërgoj mbi të dërguarin e Tij fisnik i cili na vizoi rrugën drejt kënaqësisë së All-llahut [subhanehu ve tealja] dhe xhennetit të Tij. Rrugë në të cilën nuk ka shtrëmbërime e ku skajet e saj mbledhin gjithë fisnikërinë dhe moralet më të larta pas të cilave vjen pastërtia, mbulesa dhe dëlirësia. Dhe është kjo rruga e cila udhëheq të dy krahët e shoqërisë njerzore gruan dhe burrin drejt shtigjeve të kënaqësisë shpirtore, qetësisë dhe lumturisë në këtë botë dhe në atë të përtejmen. Dhe po për këtë arsye Zoti ynë i madhëruar obligoi ndaj gruas mbulesën (hixhabin) për të ruajtur dëlirësinë e saj dhe për të mbrojtur po këtë fisnikëri e për të qenë ky hixhab shenjë dalluese e besimit të saj. Dhe si rezultat i kësaj shoqëria e cila largohet nga rruga e All-llahut [subhanehu ve tealja] duke iu shmangur vijës së Tij të drejtë kthehet në një shoqëri të sëmure që ka nevojë për ilaçin i cili do ta çojë drejt shërimit dhe lumturisë. Një nga pamjet e cila tregon largimin e shoqërisë nga kjo rrugë dhe e shfaq atë me një saktësi si barometër është edhe përhapja e fenomenit të zhveshjes dhe zbulimit në rradhën e të rejave. Ky fenomen për fat të keq është bërë mjaft i dukshëm në shoqërinë islame megjithë përhapjen e veshjes islame në këto vende. Cilat janë shkaqet të cilat çuan deri në këtë pikë? Kjo ishte pyetja të cilën për përgjigje ne ia drejtua grupet e ndryshme vajzash dhe rezultati që morrëm mund të përmbilidhet në dhjetë arsye kryesore, ku konstatuam mbas një vështrimi të kujdesshëm se sa të dobta ishin këto arsye! Le t'i shfletojmë bashkë këto faqe, motër muslimane, për të parë arsyet e largimit nga mbulesa duke e diskutuar çdo njëren prej tyre më vete:

Shkaku i parë: Tha e para: “Mua nuk më ka pëlqyer deri tani hixhabi”. Le ta pyesim këtë motër për dy gjëra:

1-A është ajo e kënaqur me fenë Islame? Natyrisht që përgjigjia e saj do të jetë: Po jam e kënaqur. Ajo thotë: “La ilahe il All-llah” dhe me këtë ajo tregon se e pranon këtë besim, ajo thotë: “Muhamedun resulullah” dhe me këtë ajo tregon se e pranon Sheriatin. E pra ajo e pranon dhe është e kënaqur me Islamin si besim, ligj dhe mënyrë jetese.